




ANEKS KONTRATA

Date 26.08.2020

Nr. Ref. 632-20-3896-5-3-5;
632-20-054-535

Në mes të

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

NMIQ"Montkomerce"shpk & "Euroasphalt" sh.p.k. – Gjakovë, me nr.unik 810232728 (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **" Rivitalizimi I Urës së Terezive, ndriçimi, shtigjet për ecje, gjelbërimi", nr.brendshëm 632-19-034-521**, të datës: **06.06.2019**, e cila kontratë është në realizim e sipër.


- i. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve **Rivitalizimi I Urës së Terezive, ndriçimi, shtigjet për ecje, gjelbërimi**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë, sipas ofertës së datës 21.08.2020, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Planin dinamik për kryerjen e punimeve është **5 ditë**,
3. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit prej **10%** të vlerës së kontraktuar për **35 ditë**.
4. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **2,102.50€(dymijë e njëqind e dy euro e pesëdhjetë cent)** sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. **632-20-3896-5-3-5**.

5. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
6. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
7. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
8. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	z.Faton Gutaj	Emri:	z.Genc Vesvesja
Pozita:	Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.08.2020	Data:	26.08.2020
Vula:		Vula:	